

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-Dega në Kaçanik, Departmenti i Përgjithshëm, permes gjyqtarit të vetëm gjykues Shabi Idrizi dhe Sek. Juridike, Shpresa Hoxha, në lëndën penale juridike të akuzuarit Sh.S nga ... K-Viti , i akuzuar për shkak të veprës penale, pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 259 paragrafi 1 të KPK-së, sipas propozimkuzës së Prokuroris Komunale në Ferizaj PP.nr.649/2012 të datës 14.09.2012, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësorë të hapur më 10.09.2014, në prezencë të Prokurorit Shtetror Agim Kuka, të akuzuarit Sh.S dhe mbrojtës të tij av. Y.H. nga Gjilani , muarr dhe të njejtnë ditë shpalli publikisht këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari Sh.S, nga babai V. dhe nëna M. i vajzërisë T., data e lindjes..., në Prishtinë (numri personal...) jeton në.... Viti, i martuar ,baba i 3 fëmijëve ,ka të kryer shkollen e mesme ,gjendje të mesme ekonomike, i pa punë ,pa të dhena se me parë ka qenë i gjykuar, shqiptar shtetas i Kosovës, mbrohet në liri .

Ë s h t ë f a j t o r

Se gjatë periudhës kohore shtator -tetor 2011, në.... Kaçanik, në mënyrë të kundërligjshme ka pushtuar pronën e paluajtshme-arën pronë e të dëmtuarit V. J. e evidentuar ne fletetën Poseduse me nr. 315, zona kadastrale... nr. 70917003, në atë mnyrë që i pandehuri ja kishte dhënë në shfrytëzim N.B, sepse i njejti nuk kishte qenë i interesuar që ta punoj këtë parcelë edhe përkundër vrejtjës nga ana e zyrtarëve të A. K.P. për lirimimin e kësaj palujtshmerie, ende e mban në mënyrë të kundërligjshme.

Me të cilin veprim kreu veprën penale pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 259 par. 1 të KPK-së.

Andaj duke u bazuar në dispoziten e lartëcekur ndeshkimore dhe nenin 3, 41,46,47, 48 ,75 të KPK-së dhe neni 365 dhe 453, dh e 463 të KPPK-së i shqipton;

Denim me Gjobë

Të pandehurit Sh.S nga..., i shqipton denimin me gjobë në lartësi prej 1000.00 euro (njëmijë) të cilën do e paguaj në tri kiste mujore në të kundertën kjo gjobë do i

kthehet në denim me burg , ku për qdo 20 euro gjobë do i llogaritet 1 ditë burg e gjithë kjo pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri që në afat prej 15 ditësh prej marrjes së aktgjykimit të liroj pronën e pushtuar.

Udhëzohet i dëmtuari, që kërkesën e vet pasurore juridike ta realizoj në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që të paguaj paushallin gjyqsor në lartësi prej 150.00 euro në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmerise se ktij aktgjykimi.

A r s y e t i m

PTH nga Ferizaji, me Propozimkuzën .PP. Nr. 649/2012 të datës 14.09.2012, të akuzuarin Sh.S nga..Vitis, e ka akuzuar për shkak veprës penale pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 259 paragrafi 1 të KPK-së.

Në shqyrtimin gjyqsor Prokurori shtetror pranë PTH-Ferizaj Agim Kuka në fjalën përfundimtare mbeti në tërsi pranë aktit akuzues të paraqitur me shkrim pranë kësaj gjykate dhe ndryshimin e bërë conform nenit 350 të KPPK-së ku në vend të dt. 14.Janar 2011 si dt. e kryerjës së veprës penale është përmirësuar në shtator -tetor 2011 , duke propozuar gjykatës që të akuzuarin Sh.S të e shpall fajtor për veprën penale që akuzohet dhe ti shqiptoj denim meritor sipas ligjit, ngase nga provat e shqyrtuara në shqyrtimin gjyqsor u vertetua sei pandehuri siq është përshkruar në dispozitivin e aktakuzës ka kryer këtë vepër penale e kjo u vertetua nga deklarimi i vet të akuzuarit i cili nuk e konteston faktin se kishte punuar palujtshmerinë e të dëmtuarit dhe i cili fakt vertetohet edhe nga deklarimi i deshmitarit N.B. por edhe nga vendimi i AKP-së i dt. 14.01.2011 dhe FP.nr. 315 ZK-Begracë, , dhe shkresat tjera që gjenden në shkresat e lendës.

Mbrojtsi i të akuzuarit av. Y.H. në fjalën përfundimtare deklaroj se shqyrtimi i sotëm dhe provat e prezentuara nuk vertetuan faktin se i mbrojturi im ka kryer këtë vepër penale, ngase fakti se është shfrytzuar kjo prone qysh nga viti 1999 nuk është kontestues porse ketë e kanë berë si prone e kooperativës dhe nga fakti se kjo prone i është marrë gjatë reformës agrare dhe se për të njenjtën ka pasur kontest edhe në Gjykatën Komunale në Viti , porse në anën tjetër të mbrojturit të tij asnjher nuk i është kerkuar që këtë pronë ta liroj dhe se prej majit 2012 kur ka marrë vesh se është prone private i njenjti nuk e ka shfytzuar më. Pra veprimet e të mbrojturit tim nuk përmbanë elemente të veprës penale nga neni 259 par 1 i KPK-së dhe kerkon nga gjykata që të merret aktgjykim lirues.

I akuzuari Sh.S në mbrotjen e tij në shqyrtimin gjyqsor në tërsi e ka mohuar kryerjen e veprës penale që i vehtet në barrë sipas propozimkauzës dhe propozon që gjykata të e liron nga pergjegjsia dhe në tërsi e mbeshitet fjalën përfundimtare të mbrojtstit të tij.

Në proceduren e provave gjykata bëri degjimin e deshmitarit N.B., beri shiqimin dhe leximin e provave shkresore që gjinden në shkresat e lendës; leximi i Fletës Poseduse nr. 315 ZK-Begracë, vendimin e dt. 14.01.2011 te KPA-së, Aktvendimin C.nr. 88/2001 te dt. 30.06.2003 te lëshuar nga Gjykata Komunale në Viti dhe mbrotjen e të akuzuarit.

Nga deklarata e deshmitarit N.B. nga..., gjykata verteton faktin se gjatë muajtit shtator-tetor 2011 si në dispozitiv të aktit akuzues i pandehuri kishte kërkuar ndihmë prej tij për levrimin dhe mbjelljen e palujtshmerisë kontestuese veprim të cilin e kishte berë porse gjatë vitit vijues pasi kishte mjetet e punës të njenjtin grurë e kishte korrur për llogari të të akuzuarit dhe se nuk kishte dijeni se kjo prone ishte e të akuzuarit porse ishte prone e koperativës.

Nga leximi i Fletës Poseduse nr. 315 Zona Kadastrale Begracë, K-Kaçanik, lëshuar nga Sherbimi Kadastral në Kaçanik me dt. 19.10.2007, gjykata verteton faktin se palujtshmeria kontestuese është pronë private në bashkronsi të të demtuarit V. J. dhe 2 bashkfamiliarëve të tij të gjithë nga..., Viti dhe jo pronë shoqrore e ndonjë koperative bujqsoe dhe se e njenjta ishte azhuruar qysh ne vitin 1995.

Nga leximi i vendimit KPA13241 të dt. 14.01.2011, lëshuar nga AKP-Prishtinë, gjykata verteton faktin se palujtshmeria kontestuese është prone private në bashkëpronsi të të demtuarit V. J. dhe 2 bashkfamilareve të tij të gjithë nga .., K-Viti dhe se nuk ka pasur pretendues tjerë që kanë pretenduar lidhur me pronsinë për ketë palujtshmeri dhe se pronari është udhëzuar që për lirim e pronës së tij të i drejtohet organeve lokale të pushtetit.

Nga leximi i Aktvendimit C.nr. 88/2001 i dt. 30.06.2003 lëshuar nga Gjykata Komunale në Viti lidhur me padinë e dt. 01.08.2001, gjykata verteton faktin se palujtshmeria kontestuese i akuzuari gjegjsisht prindi i tij ishte paditur për kompenzim nga ndermarrja-koperativa bujqsoe pasi i njenjti i kishte korrur grurin e saj e me vonë ishte terhjekur nga padia, pra fakti se qysh atëher ishte ne posedim të paligjshëm të pronës së huaj.

Gjykata ka bere vlersimin e provave te shqyrtuara nje nga nje dhe te gjitha sbashku dhe ka konstatuar kete gjendje faktike; Se gjatë periudhës kohore shtator-tetor 2011, në..., K-Kaçanik, në mënyrë të kundërligjshme ka pushtuar pronën e paluajtshme-arën pronë e të demtuarit V. J. e evidentuar ne fletën Poseduse me nr. 315, zona kadastrale f. Begracë nr. 70917003, në atë mnyrë që i pandehuri ja

kishte dhenë në shfrytëzim N.B., sepse i njejti nuk kishte qenë i interesuar që ta punoj këtë parcelë edhe përkundër vretjtës nga ana e zyrtarëve të agjencionit kosovar të pronës për lirim të kësaj palujtshmerie, ende e mban në mnyrë të kundërligjshme.

Kjo gjendje faktike vertetohet nga deklarata e deshmitarit N.B., vendimi i AKP-nr.13241, Fleta poseduse . Nr. 315, ZK-Begracë, porse njihërit kjo terthorazi vertetohet edhe nga deklarata e vet të akuzuarit i cili deklaronte se ai kishte punuar këtë tokë me pretendim se ishte e tij dhe se nuk kishte ditur se e njejta ishte pronë private e deklarimi të tillë gjykata nuk i fali besimin sepse nuk u mbshtet në asnjë provë të vetme kurse provat e ofruara nga ana e prokurorisë ishin bindse dhe se në asnjë moment nuk janë kundërgargumentuar nga ana e të akuzuarit i cili me pretendimin e tij se kishte inicuar procedur për kthimin e kësaj prone kontestuese gjatë viteve 90 porse gjatë luftës i janë djegur shkresat me gjithë shtëpinë , këtë nuk e argumentoi me asnjë deshmi të vetme , kurse gjykata i fali besimin provave të ofruara nga prokuroria pasi ato ishin neutrale dhe në asnjë moment nuk u vë në dyshim vertetsia e tyre nga ana e të akuzuarit. .

Gjykata vleron se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale pushtimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 259 par 1 i KPK-së, për të cilën veprë i akuzuari është penalishtë përgjegjës dhe është ndeshkuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Ky vlersim është i bazuar në pranimin e pjeshëm të fajsisë nga ana e të akuzuarit , deshmia e deshmitarit N.B. porse edhe nga provat materiale si FP.nr. 315 ZK-Begracë dhe Vendimi i AKP-së ku vertetohet plotsisht se gjatë mujait shator-tetor 2011 e në vijim i akuzuari kishte në pushtim pronën e paluajtshme të huajën dhe atë pa lejën e pronarit, pra me këtë veprim ka kryer veprën penale siq është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjës së denimit gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 75 i KPK-së të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjykata ka marrë për bazë gjendjen ekonomike të akuzuarit , sjelljen e mirë të tij gjatë tërë procedurës si dhe në shqyrtimin gjyqsor, se është baba i 3 fëmijëve , ndërsa rrethanë rënduese se kjo veprë penale është dukuri e shpeshtë dhe mjaftë e përhapur.

Gjykata është e bindur se denimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me shkallën e përgjegjësise penale të tij dhe peshën e veprës penale, keshtu që denimi i shqiptuar në lartësi prej 1000.00 euro gjobë , do arrihet qëllimi i denimit i paraparrë me nenin 41 të KPK-së.

Vendimi mbi lirim të pronës së paluajtshme është i bazuar në dispozitivin e nenit 464 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPK-së.

Vendimin që të udhëzojë palën e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasuroro-juridike në procedurë kontestimore është i bazuar në nenin 463 të KPPK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P.nr.403/12, me dt.10.09.2014

Sek. Juridike,
Shpresa Hoxha

Gjyqtari,
Shabi Idrizi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e paknaqur mund të ushtroj ankesë, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.